

VENDIM
Nr. 939, datë 26.12.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 535, DATË 7.8.2012 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUOTAT E PRANIMEVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT
TË LARTË PËR STUDIMET E CIKLIT TË PARË ME KOHË TË PJESSHME E TË EDUKIMIT
NË DISTANCË, NË VITIN AKADEMIK 2012-2013”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronjat “a” dhe “ë” të pikës 1 të vendimit nr. 535, datë 7.8.2012 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohen si më poshtë vijon:

“a) Kuotat e pranimeve të reja në programet e studimit të ciklit të parë,
me kohë të pjesshme 9035;”

...
“ë) Kuota për të përndjekurit politikë 280.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha